



# Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie

## *Qëllimi i programit:*

Duke ju referuar gjendjes aktuale në sitemin parauniversitarë të arsimit, ku mësim po zhvillohet në formë hibride duke aplikuar edhe mësimin në distancë, që nënkupton shfrytëzimin e teknologjive të edukimit dhe burimeve online si dhe në bazë të kërkesave për zhvillimin e shkathtësive dhe arritjen e kompetencave për integrimin e TIK-ut në procesin mësimor, është dizajnuar ky program trajnimi. Në bazë të përvojës sonë akademike dhe hulumtuese si dhe nga bashkëpunimet me universitetet tjera pratnere të Fakultetit të Edukimit për përgatitjen e mësimdhënësve për zhvillimin e kompetencës digjitale të paraparë edhe në Kornizen Evropiane për kompetencë digjitale të mësimdhënësve është hartuar përmbajtja e këtij program të trajnimit.

Si tregues të këtij standardi të cilët ndërlidhën me fokusin e këtij programi të trajnimit janë:

Përdorimi i strategjive të llojllojshme të mësimdhënies për t'i motivuar nxënësit dhe të nxisë të menduarit e nivelit të lartë.

Përzgjedh dhe i shfrytëzon burimet e duhura. Krijon material mësimor për temat e caktuara ku mungon literature. Përdor teknologjinë adekuate në mënyrë adekuate, të sigurt, me përgjegjësi dhe me etikë.

## *Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve :*

Ky program trajnimi synon zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve në shërbim, të klasave 1-12 për integrimin e TIK-ut në mësimdhënie me fokus rritjen e interaktivitetit mësimdhënës-nxënës dhe përdorimit të burimeve online. Ky program i trajnimit i dedikohet mësimdhënësve në shërbim të klasave 1 deri 12.

Duke ju referuar Kornizës së përgjithshme të standardeve të profesionit/kompetencave të përgjithshme, (MASHT, 2017) (MASHT, Prill 2017) ky program trajnimi është i ndërlidhur me standardin e katërt, përkatësisht me fushën shkathtësitë dhe praktikat profesionale. Ky standard ka të bëjë me planifikimin dhe zbatimin efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

## *Rezultatet e programit:*

Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimdhënësit do të jenë në gjendje të:

- përdorin teknologjitë e avancuara të informacionit dhe komunikimit për mbështetjen e mësimdhënies dhe të nxënësve elektronik dhe edukimit në distancë;
- përdorin TIK-un si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara;
- bëjnë dallimin në mes të mësimdhënies interaktive dhe asaj jointeraktive;
- krijojnë dhe shfrytëzojnë i-materialet;
- krijojnë materiale multimediale për mësimdhënie interaktive;
- përdorin PollEveryëhere për krijimin e prezantimeve interaktive në Poëer Point;
- përdorin Kahoot për gjithëpërfshirje dhe angazhim të nxënësve për të nxënë;
- shfrytëzojnë simulimet për konkretizim dhe demonstrim të përmbajtjeve mësimore;
- krijojnë dhe shfrytëzojnë klasa virtuale;
- krijojnë instrumente për vlerësim online.